



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M Nr. 11, datë 10.01.2019

MBI PEZULLIMIN NGA DETYRA TË GJYQTARIT ROLAND HYSI, PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR FIER

Këshilli i Lartë Gjyqësor i mbledhur më datë 10.01.2019, mbështetur në nenin 140 të Kushtetutës, në nenet 151, pika 1, germa “a” dhe 155 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në shkresën të Gjykatës së Shkallës së parë Për Krimet e Rënda nr. 41 prot., datë 10.01.2019, bashkëlidhur të cilës është dhe vendimi nr.05 datë 09.01.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” ndaj gjyqtarit Roland Hysi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier”,

V E N D O S I :

1. Të pezullojë nga ushtrimi i detyrës gjyqtarin Roland Hysi, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për shkak të masës së sigurisë “arrest me burg” dhënë me vendimin nr.05 datë 09.01.2019 nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR